



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Zyra Ekzekutive – Komisioni i Pavarur i Mediave

RAPORT MONITORIMI

OSHMA-të GJATË FUSHATËS PËR ZGJEDHJET E PARAKOHSHME **PËR KUVENDIN E** **REPUBLIKËS SË KOSOVËS 2019**

Periudha e monitorimit 25 shtator – 06 tetor 2019 Prishtinë

Përmbajtja

Përmbajtja	2
Akronimet e përdorura në raport	3
Përmbledhje ekzekutive	4
Baza ligjore	5
Metodologjia dhe realizimi	5
Gjetjet nga monitorimi	7
Shkeljet e gjetura	9
Veprimet e KPM-së lidhur me zgjedhjet	11
Ankesat	12
Hapësira e ofruar për SPC-të	12
Periudha e heshtjes zgjedhore	26
Raporti gjinor në debate dhe intervista	26
Sfidat dhe vështirësitë gjatë monitorimit të pajtueshmërisë së të licencuarve të KPM-së	31
Konkluzione dhe rekomandime	31
Shtojca 1 Tabelat me të dhënat e hapësirës së dhënë për SPC-të.....	34
Shtojca 2 Tabelat për raportin gjinor në debate/intervista.....	42

AKRONIMET E PËRDORURA NË RAPORT

- KPM - Komisioni i Pavarur i Mediave
- KQZ - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
- DMA - Departamenti i Monitorimit dhe Analizës i KPM-së
- SPC - Subjekt Politik i Certifikuar
- OSHMA - Ofrues i Shërbimit Medial Audio-Vizuel

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), duke qenë përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Kreut VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës¹, ka bërë monitorimin e ofruesve të shërbimeve mediale audio-vizuele (OSHMA) të cilat kanë mbuluar fushatën e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ)², për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës, të cilat janë mbajtur më 6 tetor 2019, ka certifikuar njëzetë e pesë (25) Subjekte Politike të Certifikuara (SPC): Partia Liberale Egjiptiane (PLE), Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Partia e Ashkalinjëve për Integritim (PAI), Stranka Demokratske Akcije (SDA), Partija Kosovskih Srba (PKS), Partia Demokratike e Ashkanlive të Kosovës (PDAK), Pokret za Gora (PG), Nova Demokratska Stranka (NDS), AAK- PSD Koalicioni 100% Kosovë, SLOBODA, Samostalna Liberalna Stranka (SLS), Nisma Socialdemokrate – Aleanca Kosova e Re – Partia e Drejtësisë (NISMA/AKR/PD), Jedinstvena Goranska Partija (JGP), Koalicija VAKAT, FJALA, Lëvizja Vetëvendosje (VV), Kosova Demokratik Türk Partisi (KDTP), Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), Partia Euroatlantike e Kosovës (PEK), Kosovaki Nevi Romani Partia (KNRP), Iniciativa e re Demokratike e Kosovës (IRDK), Esmir KASI, Gradanska Inicijativa Gore (GIG), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Srpska Lista (SL).

Qëllim i monitorimit, për periudhën 25 shtator deri më 6 tetor 2019, ishte vlerësimi i performancës së OSHMA-ve në pajtim me Kreun VIII të këtij Ligji, të titulluar “Mediat gjatë Fushatës së Zgjedhjeve”, si dhe Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së. Ky raport është realizuar nga Departamenti i Monitorimit dhe Analizës (DMA) i Zyrës Ekzekutive dhe prezanton të gjeturat nga monitorimi i OSHMA-ve gjatë mbulimit të fushatës zgjedhore dhe periudhës së heshtjes zgjedhore deri në mbylljen zyrtare të vendotimeve.

Në monitorim janë përfshirë shtatëmbëdhjetë (17) ofrues të shërbimeve mediale audio-vizuele, prej të cilëve:

- Tri (3) me mbulim tokësor nacional (RTK1, KTV dhe TV21);
- Nëntë (9) OSHMA me mbulim tokësor lokal/regjional (TV Dukagjini, TV Puls, TV Herc, TV Opinion, TV Besa, TV Vali, TV Most, TV Mitrovica dhe TV Iliria); dhe
- Pesë (5) OSHMA me program gjeneralistik që transmetohen përmes operatorëve të shpërndarjes (RTK2, Klan Kosova, TE7, Rrokum TV dhe TV Gracanica).

Gjatë procesit të monitorimit, në fokus ishin të gjitha format e prezantimit medial të fushatës zgjedhore si: edicionet e lajmeve, pikat politike reklamuese, kronikat zgjedhore dhe intervistat e debatet e transmetuara nga ora 16:00 deri në orën 24:00.

Zyrtarët e Departamentit të Monitorimit dhe Analizës (DMA) gjatë periudhës monitoruese kanë vlerësuar: paanshmërinë në raportim, hapësirën e ofruar për SPC-të, gjuhën e përdorur dhe, në përgjithësi, pajtueshmërinë me Udhëzuesin e KPM-së për Sjelljen e Mediave gjatë Zgjedhjeve dhe aktet tjera nënligjore përkatëse të KPM-së.

¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2544>

² http://www.kqz-ks.org/ep-content/uploads/2019/09/100_Fletevotimi_Kuvend-Kosoves_shq-sr-tr.pdf

Nga të gjeturat e monitorimit rezulton se përkundër disa përjashtimeve, prezantimi i fushatës për zgjedhjet e parakohshme nga OSHMA-të ishte kryesisht objektiv dhe i paanshëm, në pajtim me dispozitat për media në Ligjin për Zgjedhje dhe Kodin Etik për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio-Vizuele³.

Vlen të theksohet se, gjatë periudhës zgjedhore në KPM nuk është adresuar asnjë ankesë nga ndonjë palë.

II. BAZA LIGJORE

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) është përgjegjës për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme i cili përcakton në mënyrë specifike dispozitat për “Mediat gjatë Fushatës së Zgjedhjeve”.

Për të ndihmuar të licencuarit që të veprojnë në pajtueshmëri me Kreun VIII të këtij Ligji, KPM ka përcjell tek të licencuarit Udhëzuesin e KPM-së për Sjelljen e Mediave gjatë Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Kosovës⁴, i cili në fakt është interpretim më i detajuar i dispozitave të Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhje.

Udhëzuesi përbëhet prej tre kapitujve:

1. KAPITULLI I – identifikimi i reklamimit politik;
2. KAPITULLI II – raportimi për hulumtimin e opinionit publik lidhur me zgjedhjet; dhe
3. KAPITULLI III – periudha e heshtjes zgjedhore.

Sipas nenit 53 të Ligjit për Zgjedhje, KPM siguron që të licencuarit mirëmbajnë ditarë për të regjistruar kohën e emetimit dhe ekspozimeve tjera në media, për reklamim me pagesë dhe pa pagesë, të aktiviteteve të fushatës për secilin SPC. Për këtë qëllim, KPM u ka dërguar të licencuarve edhe format e ditarëve me dhe pa pagesë si dhe udhëzuesin për mënyrën e plotësimit të tyre, të cilat janë në dispozicion edhe në ueb-faqen e KPM-së⁵. Gjithashtu, KPM ka kërkuar nga OSHMA-të të njoftojnë nëse do të mbulojnë fushatës zgjedhore.

III. METODOLOGJIA DHE REALIZIMI

Metodologjia e përdorur gjatë monitorimit të performancës së ofruesve të shërbimeve mediale audio-vizuele është bazuar në analiza sasiore dhe cilësore, me theks të veçantë në edicionet qendrore të lajmeve, kronikat zgjedhore, pikat reklamuese politike si dhe intervista e debate në përmbajtjet programore të transmetuara nga ora 16:00 deri në orën 24:00. Metodologjia e

³ <http://kpm-ks.org/materiale/dokument/1476189555.8908.pdf>

⁴ <http://kpm-ks.org/materiale/dokument/1568984491.0629.pdf>

⁵ <http://kpm-ks.org/?mod=njoftimet&id=1261&gjuha=1>

monitorimit ka konsistuar në regjistrimin e programeve, kategorizimin e tyre, si dhe matjet e kohës/hapësirës për sekondë të dedikuara për secilin SPC.

Për këtë qëllim janë futur të dhëna në tabelat e dizajnuara paraprakisht, vlerësimi i prezantimit të fushatës nëse ka qenë pozitiv, negativ apo neutral, përpunimi dhe analiza e të dhënave të fituara dhe në fund hartimi i raportit final lidhur me mbulimin medial të fushatës zgjedhore. Nxjerrjen e këtyre të dhënave e mundësoi sistemi i monitorimit të cilin e posedon KPM, përmes të cilit bëhet pranimi, incizimi dhe arkivimi i programeve të transmetuara të OSHMA-ve. Gjithashtu, në situata të vështirësuar teknologjike, DMA ka kërkuar arkivën nga OSHMA-të.

Matja e hapësirës së dedikuar SPC-ve është bërë duke llogaritur kohën në sekonda në lajme, kronika zgjedhore, debate dhe intervista, për periudhën prej datës 25 shtator deri më 04 tetor 2019, nga ora 16:00 deri 24:00.

Bazuar në këto llogaritje, janë dhënë tabelat për kohën e ofruar për SPC në sekonda dhe përqindje. Analizat cilësore janë bërë për të vlerësuar nëse:

- OSHMA-të kanë raportuar në mënyrë të drejtë, korrekte, objektive dhe të paanshme;
- OSHMA-të kanë ofruar mundësi për promovimin e platformave politike të SPC-ve në garë;
- OSHMA-të kanë ofruar qasje të njëjtë për SPC-të në debate/intervista, pyetje të njëjta, mundësi për replikë në emisione debatuese, renditje të aktiviteteve zgjedhore në lajme dhe kronika zgjedhore (renditja me rotacion duke mos favorizuar prezantimin e aktiviteteve të SPC-ve me renditje të njëjtë për çdo ditë të fushatës); dhe
- OSHMA-të kanë vepruar në pajtueshmëri me heshtjen zgjedhore dhe dispozitat tjera të Ligjit për Zgjedhje.

Po ashtu, gjatë analizës është bërë edhe vlerësimi për mënyrën e prezantimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të në pajtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës dhe standardet profesionale të gazetarisë (nëse ka pasur nxitje të urrejtjes, gjuhë të papërshtatshme, denigruese, fyerje, shpifje apo shkelje të dispozitave tjera të dhëna në Kodin e Etikës) si dhe vlerësimi i pajtueshmërisë me Rregulloren 2017/07 për Komunikime Komerciale Audiovizuale⁶.

Kohëzgjatja dhe të gjeturat në këtë raport përfshijnë periudhën e monitorimit nga data 25 shtator deri më 06 tetor 2019, përfshirë periudhën e fushatës zgjedhore dhe periudhën e heshtjes zgjedhore deri në mbylljen zyrtare të vendotimeve.

Në monitorim janë përfshirë shtatëmbëdhjetë (17) ofrues të shërbimeve mediale audio-vizuale, si mostra më reprezentative për natyrën e këtij aktiviteti, prej të cilëve:

⁶ <http://kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Legjislacioni/1514284325.0124.pdf>

- tri (3) me mbulim tokësor nacional (RTK1, KTV dhe TV21);
- nëntë (9) OSHMA me mbulim tokësor lokal/regjional; dhe
- pesë (5) OSHMA me program gjeneralistik që transmetohen përmes operatorëve të shpërndarjes.

IV. GJETJET NGA MONITORIMI

Gjatë fushatës zgjedhore, OSHMA-të kanë vepruar kryesisht në pajtueshmëri me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, respektivisht Kreun VIII-të këtij Ligji.

Në përgjithësi, OSHMA-të ka ofruar përmes përmbajtjeve programore përfaqësim të drejtë dhe të paanshëm, në kuptimin e hapësirës së dhënë SPC-ve, ku kryesisht janë mbuluar SPC-të që kanë zhvilluar më tepër aktiviteteteve zgjedhore. Përyjashtim bëjnë këtu, OSHMA Rrokum TV që ka favorizuar përmes hapësirës SPC PDK, ndërsa OSHMA-të që transmetojnë në gjuhën serbe: TV Gracanica, TV Puls, TV Herc dhe TV Most kanë favorizuar në masë të madhe SPC Srpska Lista.

Raportimi i OSHMA-ve gjatë mbulimit të fushatës ishte kryesisht neutral dhe gjuha e përdorur gjatë kësaj fushate ka qenë në pajtim me Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale, me përjashtim të disa rasteve në të cilat është vërejtur se ka pasur përmbajtje të gjuhës së urrejtjes dhe shprehjeve në kundërshtim me dispozitat e përcaktuara në Kodin e Etikës. Këtu përfshihet përmbajtja e pikës reklamuese politike (spotit politik) të SPC Srpska Lista, që është transmetuar në: TV Puls, TV Gracanica, TV Most, TV Herc, njoftimi i transmetuar në TV MOST ku kishte referencë për emërtimin e vendit me shprehje si: *Juzna pokrajina, pokrajinski izbori, Kosova i Metohija*. Në OSHMA-të që transmetojnë në gjuhën serbe është vërejtur se hapësirë e madhe i është dhënë edhe përfaqësuesve politik të Serbisë, të cilët, përveç referencës së Republikës së Kosovës si krahinë, në mënyrë të drejtpërdrejt bëjnë thirrje për votim të SPC Srpska Lista.

Sa i përket reklamimit politik, është gjetur se gjatë kësaj periudhe janë transmetuar pika reklamuese politike, të cilat nuk janë identifikuar sipas përkufizimeve të përcaktuara në Ligjin për Zgjedhje dhe Udhëzuesin e KPM-së për Sjelljen e Mediave gjatë Zgjedhjeve. Raste të tilla janë vërejtur në:

RTK1

- Mos-identifikimi (me apo pagesë) i pikave reklamuese politike të KDTP, VV, PDK, AAK (25.09.2019), KDTP, SLS (27.09.2019);
- Mos-identifikimi (ceket vetëm me pagesë) i sponsorizuesit të pikave reklamuese politike të VV, AAK (27.09.2019), AAK, PDK (29.09.2019), SLS (30.09.2019), AKR, LDK (01.10.2019), LDK (02.10.2019), PDK (03.10.2019).

TV DUKAGJINI

- Mos-identifikimi (cekjet vetëm me pagesë) i sponsorizuesit të pikave reklamuese politike LDK, AAK-PSD (01.10.2019).

TE7

- Mos-identifikimi (me apo pagesë) i pikave reklamuese politike të LDK, AAK, VV, PDK (26-29.09.2019).

TV Gracanica

- Mos-identifikimi (me apo pagesë) i pikave reklamuese politike të SL (26.09-04.10.2019).

Po ashtu, gjatë kësaj periudhe është vërejtur edhe transmetimi i një pike reklamuese politike të PDK-së në të cilin ka pasur prezencë të fëmijëve, por i njëjti ka vazhduar të transmetohet pastaj pa pjesën ku përfshihen fëmijët. Kjo pikë reklamuese politike është transmetuar në: KTV (29.09.2019) dhe Klan Kosova (30.10.2019).

Në kundërshtim me Rregulloren për Komunikime Komerciale Audiovizuale, është vërejtur se gjatë kësaj periudhe janë transmetuar programe informative dhe programe të çështjeve aktuale (debate politike) të cilat kanë qenë të sponsorizuara, me përmbajtje të vendosjes së produkteve dhe reklamim me ekran të ndarë.

Shkelje janë vërejtur në: programet “Magazina Zgjedhore” Klan Kosova (25 shtator - 4 tetor 2019), në të cilat ka pasur vendosje të produktit, programet “Rubikon” KTV (25,26,27 shtator, 02 dhe 03 tetor 2019), “Interaktiv” KTV (25 shtator - 4 tetor 2019), “Debat Pernime” TV 21 (25 shtator - 4 tetor 2019), të cilat kanë qenë të sponsorizuara dhe ka pasur vendosje të produkteve, programet “Debat Plus” TV Dukagjini (25 shtator - 4 tetor 2019), “Zona Zgjedhore” Klan Kosova (25 shtator - 4 tetor 2019), “Pressing” TE7, “DPT” TE7 (25 shtator - 4 tetor 2019), që përveç sponsorizimit dhe vendosjes së produkteve ka pasur edhe reklamim me ekran të ndarë.

Ndërsa, gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore, që ka filluar njëzetekatër (24) orë para hapjes së vendotimeve deri në mbylljen zyrtare të vendotimeve, me përjashtim të disa rasteve, OSHMA-të kanë vepruar në pajtim me menin 52.1 të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Gjatë ditës së votimit, në përgjithësi OSHMA-të kanë raportuar rreth mbarëvajtjes së procesit zgjedhor, përfshirë këtu mbulimin e konferencave të KQZ-së, intervista me përfaqësues të qendrave të votimit, qytetarë etj..

Shkelje të heshtjes zgjedhore është vërejtur në Klan Kosova. Në ditën e zgjedhjeve, në Klan Kosova është identifikuar vetëm një shkelje rreth orës 14:30, me rastin e transmetimit të drejtpërdrejt të konferencës për media të shtabit zgjedhor të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK). Gjatë kësaj konference, nga përfaqësuesi i këtij subjekti, z. A.Tahiri, ndër të tjera, bëhet thirrje që të votohet qeveria e ardhshme e PDK-së. Më pas, nga moderatori në studio kërkohet

falje publike për shkeljen e heshtjes zgjedhore me rastin e transmetimit të këtij materiali dhe po ashtu moderatorin bënë thirrje për gazetarët dhe SPC-të që të respektojnë heshtjen zgjedhore. Gjithashtu, pas kërimit faljes publike në Klan Kosova, kjo OSHMA ka dërguar edhe zyrtarisht shkresë KPM-së për të sqaruar këtë rast.

V. SHKELJET E GJETURA

Nga monitorimi i OSHMA-ve që kanë mbuluar fushatën zgjedhore është vërejtur se, me përjashtim të disa rasteve, OSHMA-të kanë vepruar në pajtim me Kreun VIII të Ligjit për Zgjedhje dhe Kodin e Etikës për Shërbimet Mediale Audiovizuale.

Shkeljet e evidentuara kanë të bëjnë me:

- Gjuhën e përdorur në përmbajtje programore, pika reklamuese politike dhe nga vet ofruesi i shërbimit medial audiovizuel;
- Reklamimin politik – mos identifikimi i duhur;
- Përdorimin e fëmijëve në spote politike;
- Reklamimi me ekran të ndarë, sponsorizimi dhe vendosja e produkteve në programe informative dhe debate zgjedhore; dhe
- Shkeljen e periudhës së heshtjes zgjedhore.

Lidhur me gjuhën e përdorur në përmbajtje programore, është gjetur se gjatë kësaj periudhe janë transmetuar përmbajtje programore me përmbajtje të gjuhës së papërshtatshme.

Sipas Kodit të Etikës për Shërbimet Mediale Audiovizuale, përkatësisht nenit 5.1 parashihet që:

“OSHM-të nuk duhet të nxisin ose promovojnë, qëllimisht ose në mënyrë indirekte, cilëndo nga format e diskriminimit dhe të jo tolerancës dhe nuk duhet të transmetojnë asnjë material që njollosë një grup etnik apo fetar, apo që nënkupton se një grup etnik apo fetarë është përgjegjës për aktivitete kriminale”.

Sa i përket reklamimit politik, është vërejtur se gjatë periudhës monitoruese janë transmetuar pika reklamuese politike të cilat nuk janë identifikuar nëse janë me apo pa pagesë, apo raste kur këto janë identifikuar se janë me pagesë por nuk është identifikuar sponsorizuesi (organizata ose individi përgjegjës për të).

Në bazë të nenit 49.6 i Ligjit Nr. 03/L-073 përcaktohet që:

“Transmetuesit përkujdesen që çdo pikë reklamuese politike të identifikohet qartë si e tillë dhe të tregojë qartë organizatën ose individin përgjegjës për të”.

Ndërsa, në Udhëzuesin e KPM-së për Sjelljen e Mediave gjatë Zgjedhjeve, përcaktohet se:

“Pavarësisht nëse reklamimi politik emitohet në kohën e blerë apo si pjesë e kohës pa pagesë të cilën ofruesi i shërbimit medial audiovizuel ua ofron subjekteve politike, teksti duhet të thotë se është “reklamim politik i sponsoruar nga [emri i partisë, organizatës, ose individi i cili ka paguar për kohën apo ka kërkuar pjesën e kohës pa pagesë]”.”

Shkelje është evidentuar edhe sa i përket përdorimit të fëmijëve në pika reklamuese politike. Gjatë kësaj periudhe është identifikuar vetëm një pikë reklamuese politike në të cilin ka pasur prezencë të fëmijëve.

Sipas Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale, përkatësisht nenit 9, paragrafi 7, theksohet që:

“Nuk lejohet përdorimi dhe prezenca e fëmijëve në spotet e ndryshme promovuese të partive politike.”

Sa i përket Rregullores për Komunikimet Komerciale Audiovizuale, shkelje janë vërejtur sa i përket formave të Komunikimeve Komerciale Audiovizuale si: sponsorizimi, vendosja e produktit dhe reklamimi me ekran të ndarë në programe informative dhe programe të çështjeve aktuale, përkatësisht debateve zgjedhore.

Sipas paragrafit 1 nenit 12 të kësaj Rregulloreje, thuhet se:

“Reklamimi me ekran të ndarë nuk duhet të jetë i tepërt në atë mënyrë që do t’ua pamundësonte shikuesve të vazhdojnë të shikojnë përmbajtjen editoriale dhe nuk duhet të përdoret në programet e fëmijëve, të fesë, të lajmeve dhe ato të çështjeve aktuale. Dispozitat e kësaj Rregulloreje në lidhje me orarin dhe kohëzgjatjen e reklamimit televiziv dhe teleshopingut do të zbatohen për reklamimin me ekran të ndarë.”

Ndërsa paragrafi 3 i nenit 14 thekson se: *“Programet e lajmeve dhe ato të çështjeve aktuale nuk do të sponsorizohen”.*

Paragrafi 1 i nenit 15 thekson se: *“Vendosja e produkteve do të ndalohej”.* Por, vendosja e produktit, sipas paragrafit 2, nënparagrafët 2 dhe 3, kjo lejohet në programe të caktuara, duke përjashtuar programet informative dhe ato të çështjeve aktuale.

Pra, sipas nenit 2 përcaktohet se:

“2. Duke e përjashtuar paragrafin 6 të këtij neni, vendosja e produkteve do të jetë e lejueshme:

2.1. Në punimet kinematografike, filma dhe seri të bëra për shërbimet mediale audiovizuale;

2.2. Programet sportive dhe programet e lehta argëtuese, me përjashtim të programeve të fëmijëve.”

Në periudhën e heshtjes zgjedhore, përkatësisht ditën e votimit, është identifikuar vetëm një rast i shkeljes së heshtjes zgjedhore, me rastin e transmetimit të konferencës për media të një subjekti politik të certifikuar, me ç’rast është bërë thirrje për votim të atij subjekti.

Sipas nenit 52.1 të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhje përcaktohet se: *“Asnjë person ose medium nuk transmeton ose publikon çfarëdo materiali që i takon aktivitetit të fushatës gjatë periudhës që fillon 24 orë para hapjes së vendotimeve deri në mbylljen zyrtare të vendotimeve”*.

Neni 53 i Ligjit për Zgjedhje përcakton që:

“Komisioni i Pavarur për Media siguron se mediat mirëmbajnë një ditar për të regjistruar kohën e emetimit, dhe ekspozimeve tjera të mediave, për reklamim me pagesë dhe pa pagesë, të aktiviteteve të fushatës për secilën parti. Ditari i vlerëson të gjithë treguesit relevant të ekspozimeve, ndaras për secilin subjekt politik, sipas mënyrës së përcaktuar me rregullat e KPM-së”.

Sa i përket pajtueshmërisë së OSHMA-ve me nenin 53 të Ligjit për Zgjedhje, KPM pas pranimit dhe rishikimit të të dhënave të ofruara, do të vlerësojë pajtueshmërinë e të licencuarve me dispozitën ligjore të përcaktuar.

Lidhur me shkeljet e gjetura gjatë periudhës së zgjedhjeve të parakohshme, KPM do të ndërmerr veprime ligjore në bazë të Ligjit të KPM-së.

VI. VEPRIMET E KPM-SË LIDHUR ME ZGJEDHJET

Për të ndihmuar të licencuarit që të veprojnë në pajtueshmëri me Kreun VIII të këtij Ligji, KPM para fillimit të fushatës zgjedhore ka përcjell tek të licencuarit Udhëzuesin e KPM-së për Sjelljen e Mediave gjatë Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Kosovës. I njëjti është publikuar edhe në ueb-faqen e KPM-së.

Më 18 shtator 2019, para fillimit të fushatës zgjedhore, KPM në mbështetje edhe të OSCE-së, ka organizuar takim konsultativ⁷ me të licencuarit e KPM-së, me qëllim të diskutimit rreth procesit zgjedhor, përkatësisht obligimet e mediave sipas Ligjit për Zgjedhje dhe akteve nënligjore të KPM-së. Në takim janë prezantuar shkeljet më të shpeshta të gjetura nga KPM gjatë proceseve zgjedhore të kaluara, me qëllim të evitimit të tyre në këto zgjedhje.

Më 20 shtator 2019, përmes një njoftimi për media⁸, KPM ka kërkuar nga të licencuarit të veprojnë në pajtueshmëri me legjislacionin e aplikueshëm gjatë procesit zgjedhor. Nga të licencuarit është kërkuar gjithashtu dorëzimi i ditareve për zgjedhje në KPM, në pajtim me Ligjin për Zgjedhje.

Më 2 tetor 2019, përmes një komunikate për media⁹, ka ftuar të licencuarit të kontribuojnë me profesionalizëm në mbulimin e periudhës së mbetur të procesit zgjedhor, sa i përket raportimit të drejtë, të paanshëm, të ofrojnë mundësi për publikun për të paraqitur shqetësimet, opinionet dhe nevojat e tyre, të ofrojnë mundësi për promovimin e platformave politike të SPC-ve, të jenë të

⁷ http://kpm-ks.org/lajmi_i_plot/3075

⁸ http://kpm-ks.org/lajmi_i_plot/3076

⁹ http://kpm-ks.org/lajmi_i_plot/3080

vëmendshëm sa i përket gjuhës së përdorur në përmbajtjet programore me qëllim të evitimit të përdorimit të gjuhës së papërshtatshme, ofenduese dhe gjuhës së urrejtjes, veçanërisht nga pjesëmarrësit në programe të drejtpërdrejta. Përmes kësaj komunikate, KPM në përgjithësi ka kërkuar të licencuarit respektimin e legjislacionit në fuqi, përfshirë Ligjin për Zgjedhje dhe akteve nënligjore të KPM-së, sa i përket dispozitave që kanë të bëjnë me zgjedhjet në përgjithësi.

Më 05 tetor 2019, përmes një komunikate për media¹⁰, KPM ka njoftuar të licencuarit për fillimin e heshtjes zgjedhore dhe ka kërkuar respektimin e kësaj periudhe deri në mbylljen zyrtare të vendotimeve, sa edhe zgjatë kjo periudhë.

Më 06 tetor 2019, pas gjetjeve nga monitorimi për thyerje të heshtjes zgjedhore, KPM ka reaguar përmes një komunikate për media, me anë të së cilës është kërkuar nga të licencuarit që të përmbahen ndaj çfarëdo materiali që i takon aktivitetit të fushatës në periudhën e heshtjes zgjedhore, me qëllim të evitimit të transmetimit të çfarëdo lloji të materialit që përbënë thyerje të heshtjes zgjedhore.

Gjithashtu, përfaqësuesit e KPM-së kanë dhënë intervista në tre (3) OSHMA duke ofruar sqarime të detajuara se si duhet të raportohet gjatë periudhës së zgjedhjeve në përgjithësi, e në veçanti gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore.

Lidhur me shkeljet e gjetura gjatë periudhës së zgjedhjeve, KPM do të ndërmerr veprime ligjore në pajtim me nenin 30 të Ligjit për KPM-në.

VII. ANKESAT

Gjatë periudhës së zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në KPM nuk është parashtruar asnjë ankesë.

VIII. HAPËSIRA E OFRUAR PËR SPC-të


Të dhënat në tabelat më poshtë, lidhur me hapësirën e ofruar për SPC-të nga data 25 shtator deri më 06 tetor 2019, janë vetëm për periudhën kohore nga ora 16:00-24:00 gjatë së cilës është bërë monitorimi. *Të dhënat e detajuara në sekonda dhe përqindje të ofruara në lajme/kronika dhe debate/intervista, janë dhënë në shtojcën 1 të këtij raporti.*

OSHMA-të me mbulim tokësor nacional


Në këtë raport të monitorimit janë të përfshirë tri (3) OSHMA me mbulim tokësor nacional, prej të cilave një publik (RTK1) dhe dy komercial (KTV dhe TV21).

¹⁰ http://kpm-ks.org/lajmi_i_plot/3081


RTK1 - Gjatë periudhës monitoruese, në këtë OSHMA është dhënë kjo hapësirë për SPC-të në lajme/kronika zgjedhore: LDK 19.79%, PDK 16.97%, VV 18.32%, AAK-PSD 15.22%, NISMA-AKR-PD 16.78%, Fjala 0.92%, SL 2.26%, PEK 1.70%, SLOBODA 0.28%, SLS 2.11%, NDS 0.39%, PLE 0.23%, SDA 1.04%, KOALICIJA VAKAT 1.67%, KDTP 0.24%, PREBK 1.15%, KNRP 0.61% dhe ESMIR KASI 0.61%.




Ndërsa, në debate është dhënë kjo hapësirë: LDK 20.05%, PDK 20.02%, VV 16.37%, AAK-PSD 11.55%, NISMA-AKR-PD 18.57%, FJALA 3.75%, PEK 3.75%, PAI 1.47%, PKS 0.07%, PDAK 1.47%, PREBK 1.47% dhe KNRP 1.47%.




KTV - në këtë OSHMA, në lajme/kronika zgjedhore është dhënë kjo hapësirë për SPC-të: LDK 18.03%, PDK 19.44%, VV 16.26%, AAK-PSD 17.60%, NISMA-AKR-PD 18.54%, SL 2.11%, SLOBODA 2.16%, JGP 0.52%, PKS 0.52%, IRDK 2.74% dhe Esmir Kasi 2.09%.




Ndërsa, në debate dhe intervista është ofruar kjo hapësirë për SPC: LDK 17.78%, PDK 23.53%, VV 24.05%, AAK-PSD 22.16%, NISMA-AKR-PD 12.14% dhe Esmir Kasi 0.34%.



RTV21 – kjo OSHMA, përmes edicioneve të lajmeve dhe kronikave zgjedhore ka ofruar për SPC këtë hapësirë: LDK 16.94%, PDK 19.66%, VV 18.51%, AAK-PSD 16.61%, NISMA-AKR-PD 10.83%, FJALA 4.45%, PEK 4.76%, SLOBODA 5.22%, SLS 1.50% dhe PKS 1.50%.




Kurse në debate, për SPC është ofruar kjo hapësirë: LDK 22.56%, PDK 10.72%, VV 19.76%, AAK-PSD 22.56%, NISMA-AKR-PD 18.15%, NDS 2.32%, PLE 2.32% dhe SDA 1.61%.




OSHMA-të me mbulim tokësor lokal/regjional

Në periudhën monitoruese në këtë raport janë të përfshirë nëntë (9) OSHMA me mbulim tokësor lokal dhe regjional: TV Dukagjini, TV Puls, TV Besa, TV Opinion, TV Vali, TV Herc, TV Most, TV Mitrovica dhe TV Iliria.


TV DUKAGJINI – përmes edicioneve të lajmeve dhe kronikave zgjedhore ka ofruar këtë hapësirë: LDK 16.61%, PDK 18.11%, VV 17.82%, AAK-PSD 19.42%, NISMA-AKR-PD 12.04%, FJALA 1.83%, SL 0.93%, PEK 3.37%, SLOBODA 3.72%, SLS 0.71%, PLE 2.17%, PDAK 1.01%, KOALICIJA VAKAT 0.81%, KDTP 0.60%, PREBK 0.58% dhe IRDK 0.27%.




Në debate dhe intervista, kjo OSHMA ka ofruar hapësirë për SPC si në vijim: LDK 18.40%, PDK 20.20%, VV 16.13%, AAK-PSD 25.89%, NISMA-AKR-PD 13.68%, FJALA 0.77%, PEK 3.50%, SLOBODA 1.14% dhe PLE 0.29%.




TV PULS – kjo OSHMA në edicione të lajmeve këtë hapësirë për SPC: AAK-PSD 1.95%, SL 85.24%, SLOBODA 2.72%, SLS 4.69% dhe PKS 5.39%.




TV BESA – përmes hapësirë së dhënë në edicione të lajmeve, kjo OSHMA ka mbuluar aktivitetet e këtyre SPC-ve: LDK 8.88%, PDK 25.64%, VV 17.13%, AAK-PSD 12.24%, NISMA-AKR-PD 28.95%, FJALA 2.66%, PEK 1.93% dhe NDS 2.57%.




TV OPINION – në edicione të lajmeve, kjo OSHMA ka ofruar hapësirën si në vijim: LDK 18.06%, PDK 22.95%, VV 16.31%, AAK-PSD 22.79% dhe NISMA-AKR-PD 19.90%.




TV VALI – përmes hapësirë së dhënë në lajme dhe kronika zgjedhore, nga kjo OSHMA janë mbuluar aktivitetet e SPC-ve në vijim: LDK 13.91%, PDK 23.27%, VV 22.45%, NISMA-AKR-PD 19.52%, PEK 14.07%, SLOBODA 2.26%, SLS 2.26% dhe PKS 2.26%.



TV HERC – në edicionet e lajmeve kjo OSHMA ka mbuluar vetëm aktivitetet e SPC SL.



TV MOST – kjo OSHMA ka ofruar përmes edicioneve të lajmeve këtë hapësirë për SPC: SL 88.20%, SLOBODA 4.11%, SLS 5.16% dhe PKS 2.52%.




TV MITROVICA – Në bazë të monitorimit është vërejtur se kjo OSHMA nuk ka përcjell aktivitetet e fushatës zgjedhore të kandidatëve pjesëmarrës në zgjedhje përmes programit të vet.

TV ILIRIA – Nga monitorimi i këtij subjekti është vërejtur se kjo OSHMA nuk ka përcjell aktivitetet e fushatës zgjedhore të SPC-ve.


OSHMA-të që operojnë përmes OSH-ve

Në këtë monitorim janë përfshirë pesë (5) OSHMA-ve që operojnë përmes OSH-ve: RTK2, Klan Kosova, TE7, Rrokum TV dhe TV Gracanica.


RTK2 – përmes edicioneve të lajmeve, kjo OSHMA ka ofruar këtë hapësirë për SPC: LDK 6.74%, PDK 6.86%, VV 4.55%, AAK-PSD 5.19%, NISMA-AKR-PD 5.19%, FJALA 0.20%, SL 25.21%, PEK 0.15%, SLOBODA 17.14%, SLS 19.72% dhe PKS 9.05%.




Ndërsa në debate/intervista është ofruar kjo hapësirë: SL 22.15%, SLOBODA 33.44%, SLS 16.51%, NDS 0.41%, SDA 0.67%, PKS 25.25%, VAKAT 0.56%, ESMIR KASI 1.00%.




KLAN KOSOVA – kjo OSHMA përmes hapësirës së dhënë në edicione të lajmeve dhe kronikave zgjedhore ka mbuluar aktivitetet e SPC-ve në vijim: LDK 18.30%, PDK 20.81%, VV 23.05%, AAK-PSD 17.47%, NISMA-AKR-PD 15.38%, SL 2.54% dhe SLOBODA 2.45%.




Në debate dhe intervista, gjatë kësaj periudhe kjo OSHMA ka ofruar këtë hapësirë për SPC: LDK 19.42%, PDK 17.11%, AAK-PSD 36.74%, NISMA-AKR-PD 26.73%.




TE7 – përmes edicioneve të lajmeve nga kjo OSHMA janë mbuluar SPC-në vijim: LDK 18.95%, PDK 17.14%, VV 18.45%, AAK-PSD 13.13%, NISMA-AKR-PD 19.57% dhe IRDK 12.76%.




Në debate dhe intervista hapësira e dhënë për SPC është si në vijim: LDK 16.40%, PDK 20.44%, VV 21.92%, AAK-PSD 21.63% dhe NISMA-AKR-PD 19.61%.




RROKUM TV – përmes hapësirës në lajme dhe kronika zgjedhore, kjo OSHMA ka mbuluar aktivitetet e këtyre SPC-ve: LDK 8.65%, PDK 64.84%, VV 8.16%, AAK-PSD 10.86% dhe NISMA-AKR-PD 7.50%.



Gjatë periudhës monitoruese, kjo OSHMA ka transmetuar vetëm një intervistë me një kandidat të SPC PDK.



TV GRACANICA – Në këtë OSHMA përmes edicioneve të lajmeve janë mbuluar vetëm dy SPC: AAK-PSD 3.25% dhe SL 96.75%



IX. PERIUDHA E HESHTJES ZGJEDHORE


Gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore, OSHMA-të kanë raportuar kryesisht në mënyrë korrekte, në pajtueshmëri me Kreun VIII të Ligjit për Zgjedhje si dhe Kodin e Etikës për OSHMA-të.

Me përjashtim të një rasti, OSHMA-të kanë raportuar në përgjithësi në mënyrë të drejtë dhe të paanshme për ecurinë e mbarëvajtjes së zgjedhjeve.


X. RAPORTI GJINOR NË DEBATE DHE INTERVISTA

Në bazë të të dhënave nga monitorimi i OSHMA-ve gjatë periudhës 25 shtator deri më 04 tetor 2019, për periudhën prej orës 16:00 deri në ora 24:00, janë nxjerr edhe të dhënat sa i përket përfaqësimit gjinor në debate dhe intervista.


Në debate/intervista në RTK1, është dhënë kjo hapësirë: kandidatë meshkuj 82.67% dhe femra 17.33%. Në vijim të dhënat në tabelë paraqesin përfaqësimin gjinor të SPC-ve në debate.



Në debate/intervista në KTV, është dhënë kjo hapësirë: kandidatë meshkuj 80.05% dhe femra 19.95%.




Në debate/intervista në TV21, është dhënë kjo hapësirë: kandidatë meshkuj 69.63% dhe femra 30.37%.




Nga nëntë (9) OSHMA me mbulim tokësor lokal/regjional të përfshirë në monitorim, hapësirë përmes debateve/intervistave ka ofruar vetëm TV Dukagjini.

Sa i përket përfaqësimit gjinor në debate dhe intervista, në TV Dukagjini kandidatët meshkuj janë përfaqësuar me 89.57%, ndërsa kandidatet femra me 10.43%.




Nga pesë (5) OSHMA që operojnë përmes OSH-ve që janë përfshirë në këtë monitorim, vetëm TV Gracanica nuk ka ofruar hapësirë në debate dhe intervista për SPC.


Në RTK2 në debate dhe intervista, kandidatët meshkuj janë përfaqësuar me 99.59% dhe kandidatet femra me 0.41%.




Në KLAN KOSOVA në debate dhe intervista, kandidatët meshkuj janë përfaqësuar me 86.03% dhe kandidatet femra me 13.97%.




Në Rrokum TV, gjatë kësaj periudhe, është ofruar vetëm një debat për një kandidat të një subjekti politik.



Në TE7, në hapësirën e dhënë në debate dhe intervista, kandidatët meshkuj janë përfaqësuar me 92.04% dhe kandidatet femra me 7.96%.



Në përgjithësi, në këto OSHMA në debate dhe intervista, kandidatët meshkuj janë përfaqësuar me 85.10% dhe ato femra me 14.90%.



Nga të dhënat e mësipërme shihet se përfaqësimi i femrave nga SPC-të në krahasim me meshkujt në debate/intervista ka qenë në përqindje tepër të ulët.

XI. SFIDAT DHE VËSHTIRËSITË GJATË MONITORIMIT TË PAJTUESHMËRISË SË TË LICENCUARVE TË KPM-SË

Për shkak të vëllimit të madh të punëve dhe numrit të vogël të stafit monitorues, KPM ka monitoruar tri (3) TV me mbulim tokësor nacional, nëntë (9) TV me mbulim tokësor lokal/regjional, si dhe pesë (5) OSHMA që operojnë përmes OSH-ve, për të cilat KPM ka pasur të dhëna se do të mbulojnë fushatën zgjedhore.

Lidhur me vlerësimin e pajtueshmërisë për të licencuarit tjerë, KPM ka vendosur që të monitorohen në bazë të ankesave të parashtruara nga palët.

Me qëllim të veprimit në pajtueshmëri të të licencuarve të KPM-së me Ligjin për Zgjedhje, KPM konsideron se janë të domosdoshme takimet paraprake me OSHMA-të si dhe komunikimet e vazhdueshme me to veçmas në para fillimit dhe gjatë periudhave të fushatave zgjedhore. Për të mundësuar kryerjen e suksesshme të aktiviteteve të këtylla, KPM e konsideron të domosdoshme sigurimin e resurseve të nevojshme, buxhet shtesë në çdo vit zgjedhor i cili do t'i mundësojë:

- angazhimin e stafit shtesë dhe përgatitjen/trajnimin e tyre për monitorimin e OSHMA-ve gjatë fushatave zgjedhore;
- realizimin e aktiviteteve përgatitore para fillimit të fushatave zgjedhore;
- organizimin e takimeve dhe debateve të përbashkëta dhe individuale me përfaqësues të OSHMA-ve dhe palëve tjera të interesit, me qëllim të qartësimit të të gjitha dilemave që lidhen me mbulimin e fushatës zgjedhore (përfshirë këtu edhe ndarjen e rolit të KPM-së nga institucionet tjera përgjegjëse për procesin zgjedhor;
- Realizimin më gjithëpërfshirës së monitorimit të përmbajtjeve gjatë fushatave zgjedhore.

XII. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Në bazë të të dhënave të gjetura nga monitorimi i periudhës zgjedhore, mund të konkludohet se:

- OSHMA-të kanë raportuar kryesisht në mënyrë korrekte, në pajtueshmëri me Kreun VIII të Ligjit për Zgjedhje si dhe Kodin e Etikës për OSHMA-të, me përjashtim të disa subjekteve të monitoruara.
- Ashtu si edhe gjatë periudhave zgjedhore të mëparshme, është vërejtur se OSHMA-të që transmetojnë në gjuhën shqipe mbulojnë kryesisht aktivitete të SPC-ve nga radhët e komunitetit shumicë në vend, ndërsa ato që transmetojnë në gjuhë të komuniteteve, në këtë rast në gjuhën serbe, mbulojnë vetëm aktivitete zgjedhore të SPC-ve nga radhët e komunitetit serb dhe atë kryesisht të vetëm një subjekti. Ky është parë si një tregues se OSHMA-të janë të prirura të ofrojnë përmbajtje programore në mënyrë selektive për kategori të caktuara shoqërore dhe në baza të përkatësisë etnike.

- Gjatë fushatave zgjedhore, në raste të caktuara dhe në mënyrë të izoluar, vërehet se ka përmbajtje me elemente të gjuhës që bie në kundërshtim me shprehjet e përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
- Në periudhën e heshtjes zgjedhore, përveç një rasti të identifikuar, për të cilin edhe janë ndërmarr menjëherë veprime nga vet OSHMA-ja, OSHMA-të kanë vepruar në pajtim me Ligjin për Zgjedhje.

Në bazë të të gjeturave nga monitorimi i periudhës zgjedhore, të prezantuara më lartë, KPM rekomandon që OSHMA-të duhet që të:

- Vepron në pajtim me Ligjin për Zgjedhjet, si dhe Udhëzuesit e KPM-së lidhur me zgjedhjet, përfshirë edhe legjislacionin në fuqi, në veçanti në pajtim me Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audiovizuale;
- Sigurohen se gjuha e përdorur gjatë fushatave zgjedhore është në pajtim me Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audiovizuale, duke respektuar parimet etike, mbrojtjen e dinjitetit dhe të drejtave të njeriut, si dhe të mos përmbajë gjuhë të dëmshme, fyese, denigruese dhe gjuhë të urrejtjes apo materiale që mund të nxisin dhunë, diskriminojnë apo njollosin individ apo grupe të caktuar të shoqërisë;
- Jenë të vëmendshëm se janë përgjegjës për çdo përmbajtje të transmetuar përmes tyre, duke përfshirë këtu edhe ritransmetimin e përmbajtjeve nga subjekte tjera transmetuese;
- Ndërmarrin veprime të duhura për evitimin e përdorimit të gjuhës së papërshtatshme, denigruese, ofenduese dhe gjuhës së urrejtjes në rastet kur ndodhin në programe të drejtpërdrejta;
- Të ofrojnë informacion dhe hapësirë të balancuar dhe të barabartë për të gjithë SPC-të e përfshira në garën zgjedhore;
- Të jenë më të vëmendshëm gjatë transmetimit të pikave reklamuese politike, duke u siguruar se ato janë të identifikuara si të tilla dhe nuk ka prezencë apo prani të fëmijëve;
- Vepron në pajtim me Rregulloren për Komunikime Komerciale Audiovizuale sa i përket formave të reklamimit si: sponsorizimi, vendosja e produktit dhe reklamimi me ekran të ndarë në programe informative dhe ato për çështje aktuale, duke përfshirë këtu debatet politike që organizohet gjatë zgjedhjeve.
- Jenë më të vëmendshëm gjatë mbulimit të periudhës së heshtjes zgjedhore, veçmas gjatë transmetimeve apo ritransmetimeve të drejtpërdrejta të përmbajtjeve programore, ku ekziston mundësia e keqpërdorimit të hapësirës së ofruar qoftë nga kandidatët, qytetarët e intervistuar, për të bërë thirrje apo promovim për ndonjë SPC-je të caktuar, gjë që mund të ndikojnë në procesin zgjedhor;

- Jenë më të vëmendshëm gjatë mbulimit të periudhës së heshtjes zgjedhore, veçmas zgjedhjes së pamjeve përcjellëse të kronikave, në mënyrë që të evitohen pamje që mund të përmbajnë material që i takon aktivitetit zgjedhor, si logo/simbole dhe flamuj partiak, moto të fushatës së tyre, numrit garues apo ndonjë detaj tjetër;
- Gjatë raportimit, të kenë parasysh që në periudhën e heshtjes zgjedhore, institucioni i vetëm zyrtar për informim lidhur me mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, parregullsitë dhe keqpërdorimet e mundshme në vendvotimeve është Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ).

Monitorimi është kryer në bazë të obligimit ligjor të përcaktuar në Kreun VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës nga Departamenti i Monitorimit dhe Analizave i KPM-së.

Shtojca 1 Tabelat me të dhënat e hapësirës së dhënë për SPC-të në OSHMA-të e monitoruara për periudhën nga 25.09-04.10.2019, nga ora 16:00-24:00.

RTK1				
SPC	Lajme / Kronika		Debate/ Intervista	
	Koha (s)	Koha (%)	Koha (s)	Koha (%)
LDK	5670	19.79	19250	20.05
PDK	4863	16.97	19220	20.02
VV	5251	18.32	15719	16.37
AAK-PSD	4361	15.22	11086	11.55
NISMA-AKR-PD	4808	16.78	17829	18.57
FJALA	264	0.92	3600	3.75
SRPSKA LISTA	648	2.26	0	0
PEK	486	1.7	3600	3.75
SLOBODA	79	0.28	0	0
SLS	605	2.11	0	0
NDS	111	0.39	0	0
PLE	67	0.23	0	0
PAI	0	0	1410	1.47
SDA	93	0.32	0	0
PKS	0	0	71	0.07
PDAK	0	0	1410	1.47
KOALICIJA VAKAT	297	1.04	0	0
KDTP	480	1.67	0	0
PREBK	330	1.15	1410	1.47
KNRP	70	0.24	1410	1.47
ESMIR KASI	175	0.61	0	0
TOTAL	28658	100	96015	100

KTV				
SPC	Lajme / Kronika		Debate/ Intervista	
	Koha (s)	Koha (%)	Koha (s)	Koha (%)
LDK	1608	18.03	9850	17.78
PDK	1734	19.44	13035	23.53
VV	1450	16.26	13325	24.05
AAK-PSD	1570	17.6	12275	22.16
NISMA-AKR-PD	1653	18.54	6725	12.14
SRPSKA LISTA	188	2.11	0	0
SLOBODA	193	2.16	0	0
JGP	46	0.52	0	0
PKS	46	0.52	0	0
IRDK	244	2.74	0	0
ESMIR KASI	186	2.09	186	0.34
TOTAL	8918	100	55396	100

TV 21				
SPC	Lajme / Kronika		Debate/ Intervista	
	Koha (s)	Koha (%)	Koha (s)	Koha (%)
LDK	1712	16.94	12580	22.56
PDK	1987	19.66	5980	10.72
VV	1871	18.51	11020	19.76
AAK-PSD	1679	16.61	12580	22.56
NISMA-AKR-PD	1094	10.83	10120	18.15
FJALA	450	4.45	0	0
PEK	481	4.76	0	0
SLOBODA	528	5.22	0	0
SLS	152	1.5	0	0
NDS	0	0	1292	2.32
PLE	0	0	1292	2.32
SDA	0	0	900	1.61
PKS	152	1.5	0	0
TOTAL	10106	100	55764	100

TV DUKAGJINI				
SPC	Lajme / Kronika		Debate/ Intervista	
	Koha (s)	Koha (%)	Koha (s)	Koha (%)
LDK	1524	16.61	22432	18.4
PDK	1662	18.11	24630	20.2
VV	1635	17.82	19668	16.13
AAK-PSD	1782	19.42	31561	25.89
NISMA-AKR-PD	1105	12.04	16680	13.68
FJALA	168	1.83	940	0.77
SRPSKA LISTA	85	0.93	0	0
PEK	309	3.37	4270	3.5
SLOBODA	341	3.72	1385	1.14
SLS	65	0.71		
PLE	199	2.17	352	0.29
PDAK	93	1.01	0	0
KOALICIJA VAKAT	74	0.81	0	0
KDTP	55	0.6	0	0
PREBK	53	0.58	0	0
IRDK	25	0.27	0	0
TOTAL	9175	100	121918	100

TV PULS				
SPC	Lajme / Kronika		Debate/ Intervista	
	Koha (s)	Koha (%)	Koha (s)	Koha (%)
AAK-PSD	75	1.95	0	0
SRPSKA LISTA	3287	85.24	0	0
SLOBODA	105	2.72	0	0
SLS	208	5.39	0	0
PKS	181	4.69	0	0
TOTAL	3856	100	0	0

TV HERC				
SPC	Lajme / Kronika		Debate/ Intervista	
	Koha (s)	Koha (%)	Koha (s)	Koha (%)
SRPSKA LISTA	658	100	0	0
TOTAL	658	100	0	0

TV OPINION				
SPC	Lajme / Kronika		Debate/ Intervista	
	Koha (s)	Koha (%)	Koha (s)	Koha (%)
LDK	7445	18.06	0	0
PDK	9461	22.95	0	0
VV	6723	16.31	0	0
AAK-PSD	9398	22.79	0	0
NISMA-AKR-PD	8204	19.9	0	0
TOTAL	41231	100	0	0

TV BESA				
SPC	Lajme / Kronika		Debate/ Intervista	
	Koha (s)	Koha (%)	Koha (s)	Koha (%)
LDK	829	8.88	0	0
PDK	2394	25.64	0	0
VV	1599	17.13	0	0
AAK-PSD	1143	12.24	0	0
NISMA-AKR-PD	2703	28.95	0	0
FJALA	248	2.66	0	0
PEK	180	1.93	0	0
NDS	240	2.57	0	0
TOTAL	9336	100	0	0

TV VALI				
SPC	Lajme / Kronika		Debate/ Intervista	
	Koha (s)	Koha (%)	Koha (s)	Koha (%)
LDK	892	13.91	0	0
PDK	1492	23.27	0	100
VV	1440	22.45	0	0
NISMA-AKR-PD	1252	19.52	0	0
PEK	902	14.07	0	0
SLOBODA	145	2.26	0	0
SLS	145	2.26	0	0
PKS	145	2.26	0	0
TOTAL	6413	100	0	100

TV MOST				
SPC	Lajme / Kronika		Debate/ Intervista	
	Koha (s)	Koha (%)	Koha (s)	Koha (%)
SRPSKA LISTA	7760	88.2	0	0
SLOBODA	362	4.11	0	0
SLS	454	5.16	0	0
PKS	222	2.52	0	0
TOTAL	8798	100	0	0

RTK2				
SPC	Lajme / Kronika		Debate/ Intervista	
	Koha (s)	Koha (%)	Koha (s)	Koha (%)
LDK	274	6.74	0	0.00
PDK	279	6.86	0	0.00
VV	185	4.55	0	0.00
AAK-PSD	211	5.19	0	0.00
NISMA-AKR-PD	211	5.19	0	0.00
FJALA	8	0.20	0	0.00
SRPSKA LISTA	1025	25.21	2435	22.15
PEK	6	0.15	0	0.00
SLOBODA	697	17.14	3675	33.44
JGP	0	0.00	0	0.00
SLS	802	19.72	1815	16.51
GIG	0	0.00	0	0.00
NDS	0	0.00	45	0.41
PLE	0	0.00	0	0.00
PAI	0	0.00	0	0.00
SDA	0	0.00	74	0.67
PKS	368	9.05	2775	25.25
PDAK	0	0.00	0	0.00
PG	0	0.00	0	0.00
KOALICIJA VAKAT	0	0.00	62	0.56
KDTP	0	0.00	0	0.00
PREBK	0	0.00	0	0.00
KNRP	0	0.00	0	0.00
IRDK	0	0.00	0	0.00
ESMIR KASI	0	0.00	110	1.00
TOTAL	4066	100.00	10991	100.00

KLAN KOSOVA				
SPC	Lajme / Kronika		Debate/ Intervista	
	Koha (s)	Koha (%)	Koha (s)	Koha (%)
LDK	2621	18.3	17036	19.42
PDK	2980	20.81	15010	17.11
VV	3300	23.05	0	0
AAK-PSD	2502	17.47	32240	36.74
NISMA-AKR-PD	2202	15.38	23454	26.73
SRPSKA LISTA	363	2.54	0	0
SLOBODA	351	2.45	0	0
TOTAL	14319	100	87740	100

TE7				
SPC	Lajme / Kronika		Debate/ Intervista	
	Koha (s)	Koha (%)	Koha (s)	Koha (%)
LDK	1316	18.95	12206	16.4
PDK	1190	17.14	15213	20.44
VV	1281	18.45	16314	21.92
AAK-PSD	912	13.13	16101	21.63
NISMA-AKR-PD	1359	19.57	14595	19.61
IRDK	886	12.76	0	0
TOTAL	6944	100	74429	100

RROKUM TV				
SPC	Lajme / Kronika		Debate/ Intervista	
	Koha (s)	Koha (%)	Koha (s)	Koha (%)
LDK	1220	8.65	0	0
PDK	9150	64.84	5031	100
VV	1152	8.16	0	0
AAK-PSD	1532	10.86	0	0
NISMA-AKR-PD	1058	7.5	0	0
TOTAL	14112	100	5031	100

TV Gracanica				
SPC	Lajme / Kronika		Debate/ Intervista	
	Koha (s)	Koha (%)	Koha (s)	Koha (%)
AAK-PSD	66	3.25	0	0
SRPSKA LISTA	1965	96.75	0	0
TOTAL	2031	100	0	0

Shtojca 2 Tabelat për raportin gjinor në debate/intervista, për periudhën nga 25.09-04.10.2019, nga ora 16:00-24:00.

RTK1					
Nr.	SPC	Meshkuj	Femra	Total	
		Koha (s)	Koha (%)	Koha (s)	Koha (%)
1	LDK	19250	20.05	0	0.00
2	PDK	14454	15.05	4766	4.96
3	VV	11911	12.41	3808	3.97
4	AAK-PSD	7482	7.79	3604	3.75
5	NISMA-AKR-PD	14075	14.66	3754	3.91
6	FJALA	3600	3.75	0	0.00
7	SRPSKA LISTA	0	0.00	0	0.00
8	PEK	3600	3.75	0	0.00
9	SLOBODA	0	0.00	0	0.00
10	JGP	0	0.00	0	0.00
11	SLS	0	0.00	0	0.00
12	GIG	0	0.00	0	0.00
13	NDS	0	0.00	0	0.00
14	PLE	0	0.00	0	0.00
15	PAI	1410	1.47	0	0.00
16	SDA	0	0.00	0	0.00
17	PKS	71	0.07	0	0.00
18	PDAK	1410	1.47	0	0.00
19	PG	0	0.00	0	0.00
20	KOALICIJA VAKAT	0	0.00	0	0.00
21	KDTP	0	0.00	0	0.00
22	PREBK	705	0.73	705	0.73
23	KNRP	1410	1.47	0	0.00
24	IRDK	0	0.00	0	0.00
25	ESMIR KASI	0	0.00	0	0.00
Total		79378	82.67	16637	17.33

KTV					
Nr.	SPC	Meshkuj		Femra	
		Koha (s)	Koha (%)	Koha (s)	Koha (%)
1	LDK	5050	9.12	4800	8.66
2	PDK	11715	21.15	1320	2.38
3	VV	9155	16.53	4170	7.53
4	AAK-PSD	11515	20.79	760	1.37
5	NISMA-AKR-PD	6725	12.14	0	0.00
6	FJALA	0	0.00	0	0.00
7	SRPSKA LISTA	0	0.00	0	0.00
8	PEK	0	0.00	0	0.00
9	SLOBODA	0	0.00	0	0.00
10	JGP	0	0.00	0	0.00
11	SLS	0	0.00	0	0.00
12	GIG	0	0.00	0	0.00
13	NDS	0	0.00	0	0.00
14	PLE	0	0.00	0	0.00
15	PAI	0	0.00	0	0.00
16	SDA	0	0.00	0	0.00
17	PKS	0	0.00	0	0.00
18	PDAK	0	0.00	0	0.00
19	PG	0	0.00	0	0.00
20	KOALICIJA VAKAT	0	0.00	0	0.00
21	KDTP	0	0.00	0	0.00
22	PREBK	0	0.00	0	0.00
23	KNRP	0	0.00	0	0.00
24	IRDK	0	0.00	0	0.00
25	ESMIR KASI	186	0.34	0	0.00
Total		44346	80.05	11050	19.95

TV 21					
Nr.	SPC	Meshkuj	Femra	Total	
		Koha (s)	Koha (%)	Koha (s)	Koha (%)
1	LDK	8288	14.86	4292	7.70
2	PDK	4884	8.76	1096	1.97
3	VV	7006	12.56	4014	7.20
4	AAK-PSD	8410	15.08	4170	7.48
5	NISMA-AKR-PD	7402	13.27	2718	4.87
6	FJALA	0	0.00	0	0.00
7	SRPSKA LISTA	0	0.00	0	0.00
8	PEK	0	0.00	0	0.00
9	SLOBODA	0	0.00	0	0.00
10	JGP	0	0.00	0	0.00
11	SLS	0	0.00	0	0.00
12	GIG	0	0.00	0	0.00
13	NDS	646	1.16	646	1.16
14	PLE	1292	2.32	0	0.00
15	PAI	0	0.00	0	0.00
16	SDA	900	1.61	0	0.00
17	PKS	0	0.00	0	0.00
18	PDAK	0	0.00	0	0.00
19	PG	0	0.00	0	0.00
20	KOALICIJA VAKAT	0	0.00	0	0.00
21	KDTP	0	0.00	0	0.00
22	PREBK	0	0.00	0	0.00
23	KNRP	0	0.00	0	0.00
24	IRDK	0	0.00	0	0.00
25	ESMIR KASI	0	0.00	0	0.00
Total		38828	69.63	16936	30.37

TV DUKAGJINI					
Nr.	SPC	Meshkuj	Femra	Total	
		Koha (s)	Koha (%)	Koha (s)	Koha (%)
1	LDK	18592	15.25	3840	3.15
2	PDK	22230	18.23	2400	1.97
3	VV	14628	12.00	5040	4.13
4	AAK-PSD	30121	24.71	1440	1.18
5	NISMA-AKR-PD	16680	13.68	0	0.00
6	FJALA	940	0.77	0	0.00
7	SRPSKA LISTA	0	0.00	0	0.00
8	PEK	4270	3.50	0	0.00
9	SLOBODA	1385	1.14	0	0.00
10	JGP	0	0.00	0	0.00
11	SLS	0	0.00	0	0.00
12	GIG	0	0.00	0	0.00
13	NDS	0	0.00	0	0.00
14	PLE	352	0.29	0	0.00
15	PAI	0	0.00	0	0.00
16	SDA	0	0.00	0	0.00
17	PKS	0	0.00	0	0.00
18	PDAK	0	0.00	0	0.00
19	PG	0	0.00	0	0.00
20	KOALICIJA VAKAT	0	0.00	0	0.00
21	KDTP	0	0.00	0	0.00
22	PREBK	0	0.00	0	0.00
23	KNRP	0	0.00	0	0.00
24	IRDK	0	0.00	0	0.00
25	ESMIR KASI	0	0.00	0	0.00
Total		109198	89.57	12720	10.43

RTK2					
Nr.	SPC	Meshkuj	Femra	Total	
		Koha (s)	Koha (%)	Koha (s)	Koha (%)
1	LDK	0	0.00	0	0.00
2	PDK	0	0.00	0	0.00
3	VV	0	0.00	0	0.00
4	AAK-PSD	0	0.00	0	0.00
5	NISMA-AKR-PD	0	0.00	0	0.00
6	FJALA	0	0.00	0	0.00
7	SRPSKA LISTA	2435	22.15	0	0.00
8	PEK	0	0.00	0	0.00
9	SLOBODA	3675	33.44	0	0.00
10	JGP	0	0.00	0	0.00
11	SLS	1815	16.51	0	0.00
12	GIG	0	0.00	0	0.00
13	NDS	0	0.00	45	0.41
14	PLE	0	0.00	0	0.00
15	PAI	0	0.00	0	0.00
16	SDA	74	0.67	0	0.00
17	PKS	2775	25.25	0	0.00
18	PSDK	0	0.00	0	0.00
19	PG	0	0.00	0	0.00
20	KOALICIJA VAKAT	62	0.56	0	0.00
21	KDTP	0	0.00	0	0.00
22	PREBK	0	0.00	0	0.00
23	KNRP	0	0.00	0	0.00
24	IRDK	0	0.00	0	0.00
25	ESMIR KASI	110	1.00	0	0.00
Total		10946	99.59	45	0.41

KLAN KOSOVA					
Nr.	SPC	Meshkuj	Femra	Total	
		Koha (s)	Koha (%)	Koha (s)	Koha (%)
1	LDK	14356	16.36	2680	3.05
2	PDK	13731	15.65	1279	1.46
3	VV	0	0.00	0	0.00
4	AAK-PSD	25865	29.48	6375	7.27
5	NISMA-AKR-PD	21534	24.54	1920	2.19
6	FJALA	0	0.00	0	0.00
7	SRPSKA LISTA	0	0.00	0	0.00
8	PEK	0	0.00	0	0.00
9	SLOBODA	0	0.00	0	0.00
10	JGP	0	0.00	0	0.00
11	SLS	0	0.00	0	0.00
12	GIG	0	0.00	0	0.00
13	NDS	0	0.00	0	0.00
14	PLE	0	0.00	0	0.00
15	PAI	0	0.00	0	0.00
16	SDA	0	0.00	0	0.00
17	PKS	0	0.00	0	0.00
18	PDAK	0	0.00	0	0.00
19	PG	0	0.00	0	0.00
20	KOALICIJA VAKAT	0	0.00	0	0.00
21	KDTP	0	0.00	0	0.00
22	PREBK	0	0.00	0	0.00
23	KNRP	0	0.00	0	0.00
24	IRDK	0	0.00	0	0.00
25	ESMIR KASI	0	0.00	0	0.00
Total		75486	86.03	12254	13.97

TE7					
Nr.	SPC	Meshkuj	Femra	Total	
		Koha (s)	Koha (%)	Koha (s)	Koha (%)
1	LDK	11611	15.60	595	0.80
2	PDK	10611	14.26	4602	6.18
3	VV	16314	21.92	0	0.00
4	AAK-PSD	15372	20.65	729	0.98
5	NISMA-AKR-PD	14595	19.61	0	0.00
6	FJALA	0	0.00	0	0.00
7	SRPSKA LISTA	0	0.00	0	0.00
8	PEK	0	0.00	0	0.00
9	SLOBODA	0	0.00	0	0.00
10	JGP	0	0.00	0	0.00
11	SLS	0	0.00	0	0.00
12	GIG	0	0.00	0	0.00
13	NDS	0	0.00	0	0.00
14	PLE	0	0.00	0	0.00
15	PAI	0	0.00	0	0.00
16	SDA	0	0.00	0	0.00
17	PKS	0	0.00	0	0.00
18	PDAK	0	0.00	0	0.00
19	PG	0	0.00	0	0.00
20	KOALICIJA VAKAT	0	0.00	0	0.00
21	KDTP	0	0.00	0	0.00
22	PREBK	0	0.00	0	0.00
23	KNRP	0	0.00	0	0.00
24	IRDK	0	0.00	0	0.00
25	ESMIR KASI	0	0.00	0	0.00
Total		68503	92.04	5926	7.96

RROKUM TV					
Nr.	SPC	Meshkuj	Femra	Total	
		Koha (s)	Koha (%)	Koha (s)	Koha (%)
1	LDK	0	0	0	0
2	PDK	5031	100	0	0
3	VV	0	0	0	0
4	AAK-PSD	0	0	0	0
5	NISMA-AKR-PD	0	0	0	0
6	FJALA	0	0	0	0
7	SRPSKA LISTA	0	0	0	0
8	PEK	0	0	0	0
9	SLOBODA	0	0	0	0
10	JGP	0	0	0	0
11	SLS	0	0	0	0
12	GIG	0	0	0	0
13	NDS	0	0	0	0
14	PLE	0	0	0	0
15	PAI	0	0	0	0
16	SDA	0	0	0	0
17	PKS	0	0	0	0
18	PDAK	0	0	0	0
19	PG	0	0	0	0
20	KOALICIJA VAKAT	0	0	0	0
21	KDTP	0	0	0	0
22	PREBK	0	0	0	0
23	KNRP	0	0	0	0
24	IRDK	0	0	0	0
25	ESMIR KASI	0	0	0	0
Total		5031	100	0	0

Totali në 8 OSHMA					
Nr.	SPC	Meshkuj	Femra	Total	
		Koha (s)	Koha (%)	Koha (s)	Koha (%)
1	LDK	77147	15.21	16207	3.19
2	PDK	82656	16.29	15463	3.05
3	VV	59014	11.63	17032	3.36
4	AAK-PSD	98765	19.47	17078	3.37
5	NISMA-AKR-PD	81011	15.97	8392	1.65
6	FJALA	4540	0.89	0	0.00
7	SRPSKA LISTA	2435	0.48	0	0.00
8	PEK	7870	1.55	0	0.00
9	SLOBODA	5060	1.00	0	0.00
10	JGP	0	0.00	0	0.00
11	SLS	1815	0.36	0	0.00
12	GIG	0	0.00	0	0.00
13	NDS	646	0.13	691	0.14
14	PLE	1644	0.32	0	0.00
15	PAI	1410	0.28	0	0.00
16	SDA	974	0.19	0	0.00
17	PKS	2846	0.56	0	0.00
18	PDAAK	1410	0.28	0	0.00
19	PG	0	0.00	0	0.00
20	KOALICIJA VAKAT	62	0.01	0	0.00
21	KDTP	0	0.00	0	0.00
22	PREBK	705	0.14	705	0.14
23	KNRP	1410	0.28	0	0.00
24	IRDK	0	0.00	0	0.00
25	ESMIR KASI	296	0.06	0	0.00
Total		431716	85.10	75568	14.90